



Fjalë të rëndësishme

- * **CALENDARIO SCOLASTICO** (*Kalendari shkollor*): tregohet kur fillon dhe kur mbaron shkolla, ditët e pushimeve, etj...
- * **CANCELLINA** (*Fshirëse*): është një penë që përdoret për të fshirë bojën e stilografit.
- * **CEDOLE LIBRARIE** (*Kuponat për librat*): janë fleta që mësueset e Shkollës Fillore i dorëzojnë prindërve në ditët e para të shkollës për të shkuar tek dyqani i librave dhe për të marrë librat falas. Librat prenotohen në qershor dhe paguhen nga Bashkija.
- * **CLASSE** (*Klasë*): është grupi i nxënësve .
- * **COLLABORATORI SCOLASTICI** (*Bashkëpunëtorë të shkollës*): janë personat që bashkëpunojnë në kryerjen e punëve të ndryshme brenda Shkollës : mbikqyrja, pastrimi, etj..
- * **COMPITO** (*Detyrë*): detyrë që i jepet nxënësve nga mësueset të cilën duhet t'a kryejnë në shtëpi .
- * **COMPORAMENTO** (*Sjellje*): është mënyra se si sillet nxënësi në shkollë, me mësueset dhe me shokët.
- * **COPERTINA** (*Kopertinë*): kopertinë plastike që mbështjell fletoret. Në përgjithësi ngjyra që duhet jepet nga mësuesja për të dalluar lëndët e ndryshme.
- * **CORSI** (*Kurse*): në Shkollat e çdo lloji dhe shkalle organizohen kurse që kometojnë propozimet didaktike. Janë kurse në të cilat mësohen disiplina siç p.sh.: noti, basketbolli, volejbolli, etj. Mësuesit e këtyre kurseve janë instruktorë profesionistë.
- * **DIARIO** (*Ditar*): shënohen ditët dhe datat. Është dokumenti zyrtar që përdoret për të shkruar detyrat, shënuar lajmërimet , për të komunikuar dhe notat.
- * **DIRIGENTE SCOLASTICO**(*Drejtori/ësha*): është autoriteti që drejton Shkollën. Është përfaqësuesi legal. Në Shkollën tetëvjeçare quhet Preside.
- * **DOPO SCUOLA**(*Pas shkolle*): për të ndihmuar fëmijët për të bërë detyrat dhe për të studjuar. Në disa shkolla, organizohen pasdite pas shkolle (ora 14.30-18.00) per kohën normale (16.30-18.00). Kërkohet pagesa e një kuote ose një kontribut. Në rastet kur keni të ardhura të pakta mund të kërkohet ndihma nga shërbimet sociale duke paraqitur ISEE .



- * *FIRMA(Firma)*: firma bëhet duke shkruar emër e mbiemër. Çdo dokument, njoftim, etj...duhet të firmoset.
- * *GIUSTIFICAZIONE(Justifikimi)*: kur nxënësi/ja ka qenë në shtëpi një ose më tepër ditë, prindërit duhet t'a shkruajnë në ditar: fëmija im ka mungar në ditën/t për motive shëndeti ose familjare. Justifikimi firmoset nga një nga prindërit.
- * *GREMBIULE (Përparëse)*: përdoret në Kopësht dhe në disa klasa të Shkollës Filllore. Është e ngjashme me një këmishë dhe përdoret nga nxënësit gjatë mësimit në klasë. Është mirë të informoheni pranë Sekretarisë së Shkollës.
- * *INSEGNANTI (Mësuesit)*: janë personat që mësojnë në Shkolla. Në Shkollën Tetëvjeçare dhe të Mesme mësuesit quhen Profesorë.
- * *INTERROGAZIONE (Pyetje)*: është kur mësuesi i kërkon nxënësit të flasë mbi gjërat që ka studjuar, të përsërisë mësimin, etj...
- * *INTERVALLO (Pushim)*: ndërprerje e shkurtër e mësimit e cila mund të zgjasë 10 minuta në maksimum në të cilën mund të hajë ushqimin që ka sjedhur nga shtëpia .
- * *LABORATORIO (Laborator)*: është një klasë ku zhvillohen aktivitete praktike. Ka laboratore pikturë, kompjuteri, punime druri, muzike, etj...
- * *LEZIONE/STUDIARE (Mësim/ Studim)*: aktivitete me gojë leximi dhe studimi të një argumenti të shpjeguar në shkollë dhe që gjendet në libra.
- * *LIBRO DI LETTURA (Libër leximi)*: për italisht, gramatikë, etj.
- * *LISTA D'ATTESA (Listë pritjeje)*: kur shkruhet një fëmijë në Kopësht ose në Shkollën filllore mund të ndodhë që mos të ketë vend. Lista e pritjes është lista ku nxënësit që nuk janë rregjistruar akoma shkruhen dhe janë në pritje të vendit për rregjistrim.
- * *MATERIALE GENERALMENTE USATO (Materiale që përdoren në përgjithësi)*:

- ✓ Lapësa
- ✓ Lapësa me ngjyra
- ✓ Mprehëse (me kuti për të mbledhur mbeturinat)
- ✓ Gomë
- ✓ Vizore
- ✓ Penë me bojë uji
- ✓ Gërshërë me maje të rrumbullakosura
- ✓ Zamkë



- * *NULLA OSTA (Leje)*: kur një nxënës transferohet në një shkollë tjetër o në një qytet tjetër duhet t'i kërkojë Sekretarisë së Shkollës që frekuenton dokumentat për t'u rregjistruar në një vend tjetër.
- * *PALESTRA (Palestër)*: është hapësira ku bëhen aktivitete në lëvizje.
- * *PIDOCCHI (Morra)*: janë parazitë që ndodhen në përgjithësi në flokë. Shpesh përhapen ndërmjet nxënësve dhe mësuesit njoftojnë prindërit t'i kontrollojnë kokën fëmijëve sepse kanë takuar raste "pediculosi". Në rast se gjejnë morra duhet të shkojnë tek farmacisti i cili do të japë gjëra të përshtatshme.
- * *PISCINA (Pishina)* është hapësira ku bëhen aktivitetet dhe kursi i notit.
- * *QUADERNONI (Fletore të mëdha)*: fletore me format të madh. Mund të jenë me viza ose me kuadrata dhe madhësia e vizave varet nga zgjedhja që bën mësuesja ose klasa që frekuenton.
- * *REGOLE (Rregulla)*: në Shkollën Italiane ndalohen dënimet në trup. Ka disa rregulla që nxënësi duhet të respektojë dhe që i përkasin respektimit të rregullave të jetës shoqërore, të materialit të përbashkët, të mësuesve dhe kërkohet një impenjim personal në studim.
- * *RIENTRO (Rihyrje)*: do të thotë të kthehesh në shkollë pasdite për të vazhduar mësimin
- * *SCHEDE DI VALUTAZIONE (Dëftesa)*: Në Shkollën fillore në fund të katër muajve dhe në fund të vitit shkollor. Është një dokument ku janë shënuar notat në lëndët e ndryshme.
- * *SEGRETERIA (Sekretaria)*: është zyra që ndodhet brenda Shkollës. Shkohet në Sekretari për të dorëzuar certifikata, për të rregjistruar, etj...
- * *SEZIONE (Seksioni)*: çdo klasë ka pranë një numër dhe një shkronjë të alfabetit p.sh. A-B-etj që tregojnë seksionin.
- * *SOSPENSIONE DELLE LEZIONI (Pezullimi i mësimit)*: mësimi mund të pezullohet për festa kombëtare, greva të mësuesve, pjesëmarrjen e mësuesve në mbledhje, shkaqe të lidhura me fenomene të veçanta atmosferike p.sh: rënie bore në sasi të mëdha.
- * *SOSPENSIONE (Pezullim)*: është një masë shumë e rëndë e përdorur në përgjithësi në shkollën Tetëvjeçare dhe të Mesme. Për motive shumë të rënda nxënësi largohet nga Shkolla për një ose më shumë ditë për dënim.
- * *SUSSIDIARIO (Libër ndihmës)*: mund të jetë një libër i vetëm ose me fashikuj me lëndet e studimit matematikë, shkenca, histori e geografi. Për anglishten dhe mësimin e fesë është një libër në vete.
- * *TUTA (Tuta)*: veshje e përdorur për të zhvilluar aktivitete të edukimit fizik.



- * *USCITA SUL TERRITORIO (Dalja në territor)*: është dalja që bën nxënësi me klasën dhe mësuesen në qytet ose në afërsi. Zakonisht shkohet në këmbë ose duke përdorur mjetet publike. (teatër, bibliotekë, park, etj...)
- * *VERIFICA (Kontroll)*: janë një ose më tepër prova për të verifikuar studimin dhe përgatitjen e nxënësve. Kontrolli mund të jetë mujor, i fillimit, për katër muajt o përfundimtar.
- * *VIAGGIO D'ISTRUZIONE (Shëtitje mësimi)*: është një dalje që nxënësi bën me klasën dhe mësuesin. Parashikohen shpenzime udhëtimi në ngarkim të familjes.
- * *VOCABOLARIO o DIZIONARIO (Fjalor)*: është një libër në të cilin janë mbledhur gjithë fjalët e një Gjuhe. Ka fjalorë me përkthime të fjalëve në gjuhë të ndryshme.
- * *VOTI (Nota)*: janë numra që tregojnë shkallën e korrektesisë dhe të përgatitjes së nxënësit. 6 përfaqëson kalueshmërinë.